



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

10.01.2018, Prishtinë,
Ref:24.10.2017\581-2017

**Opinion i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj
ankesës së Devolli Group kundër gazetës Kosova Sot**

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, në mbledhjen e bordit të mbajtur më 19 dhjetor 2017, shqyrtoi ankesën e Devolli Group kundër gazetës Kosova Sot lidhur me artikullin "Klika e Shpendit jep leje të ndërtimit vetëm për ata 'lagëfytësit' që paguajnë ryshfet", botuar më 16 tetor 2017, dhe nxorri këtë

O P I N I O N

- Ankesa miratohet

A R S Y E T I M I

Në ankesë thuhet se gazeta Kosova Sot dezinformon publikun me shkrime dhe citime aspak të bazuara, duke u fshehur pas kinse prononcimeve të "analistëve" gjithnjë pa paraqitur fakte për gjetjet e tyre.

Gazeta drejton gishtin nga prokuroria e shtetit e cila nuk merr masa ndaj krimit të organizuar në Komunën e Prishtinës e cila po keqpërdorë pushtetin duke bërë krime në ndërtimtari dhe kështu me radhë. Në ankesë thuhet se në asnjërën nga shpifjet, gazeta nuk ka dhënë dhe as që është munduar të jap mbështetje të argumentuar.

KMShK, pasi e shqyrtoi ankesën dhe artikullin e lartëpërmendur vendosi se gazeta ka bërë shkelje të Kreut II (Raportimi i së vërtetës), pasi që ka botuar vetëm prononcimet e një grupi të analistëve të saj, pa i mundësuar edhe kompanisë Devolli që të prononcohet ose ndonjë organi kompetent apo ndonjë burimi të pavarur në mënyrë që të krijohej një pasqyrë më e qartë rreth temave që i ka shqyrtuar në artikull. Në këtë mënyrë edhe lexuesi do të përfitonte duke pasur parasysh se do të krijohej një spektër i gjerë i pikëpamjeve dhe fakteve në të mirë të së vërtetës.

Gjithashtu, KMShK konstatoi se gazeta nuk ka botuar asnjë prononcim të palës tjetër për çka ka qenë e obliguar sipas Kodit të Mediave të Shkruara, me çka do të përmbushej obligimi që del nga Kreu IV (E drejta për t'u përgjigjur) i Kodit të Mediave të Shkruara.

Bazuar në atë që u tha më lartë, KMShK vendosi si në dispozitiv të këtij opinionioni.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës